

HATIXHE HOXHA

NYJA E PRAPME E SHQIPES DHE PREJARDHJA E SAJ

Çështja që ka të bëjë me formimit të nyjes së prapme, padyshim që vazhdon të mbetet një çështje komplekse në gjuhësinë ballkanike. Studiuesit të cilët u morën, këtyre shekujve të fundit, me çështjen e nyjës në gjuhët ballkanike, shprehën mendime e mbajtën qëndrime të ndryshme, si në lidhje me prejardhjen, ashtu edhe në lidhje me kohën e shfaqjes së nyjës, në gjuhët si: *shqipja*, *rumanishtja*, *bullgarishtja*, *maqedonishtja* etj.

Para studiuesve shtroheshin pyetje të tilla si, nyja e prapme athua se, në cilën nga këto gjuhë mund, apo ishte më e lashtë? Cila nga këto gjuhë mund të kishte ndikuar në tjetrën, në lidhje me këtë çështje? Në një, apo më shumë gjuhë të lashta, duhet kërkuar burimi i nyjës së prapme të shqipes, bullgarishtes, rumanishtes apo maqedonishtes?

Padyshim se edhe në pyetjen që kishte të bënte me kohën se kur mund të jetë shfaqur nyja e prapme në gjuhët si: shqipja, rumanishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, studiuesit kishin gjithashtu mendime të ndara.

Prapavendosja e nyjës në gjuhën shqipe

Studiuesit e ndryshëm që ishin marrë që herët në lidhje me prapavendosjen e nyjës në gjuhën shqip, kishin nxjerrë përfundime të tilla sipas së cilëve mendohej se, nyja e prapme e shqipes duhet t'i përkiste periudhës para shek. VII-VIII të e.r.

Kështu, studiuesi Marko La Piana, mendonte se nyja e prapme e shqipes duhet të jetë përfutur para kontakteve të saj me latinishten. Ndërsa, Norbert Jokli, shprehej se nyja e prapme e shqipes është e lashtë, por se ajo është përfutur nën ndikimin e nyjës së greqishtes.¹

S. Mladenov-i, studiues, mendon se nyja në gjuhën bullgare është krijuar mjaftë herët, gjegjësisht që në sllavishten e vjetër, ndërsa shqipja dhe rumanishtja kanë nyjen e prapme, sepse këta popuj kanë prejardhje nga trakasit e romanizuar, pra edhe nyja e prapme e shqipes rrjedh nga trakishtja.²

Studiuesi sllav, P. Skok, ishte shprehur se nyja e shqipes dhe e rumanishtes është më e vjetër se e bullgarishtes.³

Në anën tjetër, studiuesi, R. G. Petrovski, shprehej se nyja e prapme e shqipes është e re e formuar aty rreth shek. XII-XV, si rezultat i ndikimit të një gjuhe

¹ E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, në: "Studime Gjuhësore, IV", Prishtinë, 1977, f. 112.

² B. Bokshi, *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984, f. 15.

³ Po aty, f. 17.

sllave të Ballkanit, d.m.th. të bullgarishtes-maqedonishtes, ose të një gjuhe romano-ballkanike.⁴

Ndërkaq, studiuesi, Bahri Beci shprehej se nyja e prapme është e hershme në gjuhën shqipe dhe rumanishte, ndërsa është e re në bullgarishte dhe maqedonishte.⁵

Ndërsa, prof. Besim Bokshi kishte ardhur në përfundim se nyja shqipes vërtetë ishte e hershme, dhe se ajo kohësisht mund të përcaktohet në prag të huazimeve latine, porse atëherë kishim të bënim me nyjen prepozitive. Ndërsa, në lidhje me nyjën e prapme ai shprehej kështu për “kohën e aglutinimit të nyjës së prapme rreth shekullit VIII. Kjo do të thotë pra aty në Mesjetën e hershme dhe jo në Antikë, kur shtyhet substrati”.⁶

Për ne është me interes të paraqesim edhe mendimin e prof. Çabej, i cili shprehej se: “Rrethanat e veçanta të fonetikës historike të shqipes na lejojnë të hedhim vështrime retrospektive e të ngjitemi në disa faza të moçme të shqipes. Aty vërtetohet se artikulli pospozitiv është i lashtë, sepse ai na shpie në periudhën prehistorike të shqipes”.⁷

Nyja e shqipes burimi

Padyshim se për studiuesit të cilët u morën me studimin e nyjës së prapme të shqipes, ishte me interes të dihej prejardhja e saj, prandaj edhe me një rast ishte shprehur studiuesi, J. Gjinari se, edhe për ne me shumë interes është të vërtetohet se nyja e prapme e shqipes, a ka një burim të brendshëm të prejardhjes apo është ndikim i jashtëm i gjuhëve të tjera të Ballkanit.⁸

Prof. Rexhep Ismajli, shprehej se në gjuhësinë krahasimtare, ku ishte përhapur teza për vjetërsinë e madhe të nyjës së prapavendosur në shqipen, lindën teori nga më të ndryshmet për origjinën e prapavendosjes së nyjës nga protoshqipja (ilirishtja, trako-dakishtja) e me këtë edhe përkrahet teza për vjetërsinë e madhe të nyjës së shquar në shqipen pikërisht në pozitë të prapavendosur, me përjashtim të S. Rizës, i cili krijimin e nyjës në shqipen e shëh të vjetër mbi dy mijë vjet, por në pozitë të paravendosur.⁹

Studiuesi kroat, H. Bariq, mbështeste, mendimin e N. Joklit se nyja e prapme e gjuhës shqipe është e vjetër, duke e menduar të kohës shqiptaro-trako-armene.¹⁰

Edhe studiuesi, V. Georgiev, thoshte Prof. Besim Bokshi, ka shfaqur gjithashtu mendimin për ndikimin e greqishtes së vjetër, në krijimin e nyjës në

⁴ J. Gjinari, *Mbi nyjen e prapme të shqipes në aspektin e lidhjeve gjuhësore iliro-shqiptare*, në: “Studime ilire, II”, Tiranë, 1974, f. 121.

⁵ B. Beci, *Tiparet e përbashkëta gjuhësore ballkanike në dritën e të dhënave të gjuhës shqipe*, në: Seminari XVIII Ndërkombëtar Për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1996, f. 455-464.

⁶ R. Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, f. 71.

⁷ B. Bokshi, *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984, f. 51.

⁸ J. Gjinari, *Mbi nyjen e prapme të shqipes në aspektin e lidhjeve gjuhësore iliro-shqiptare*, në: “Studime ilire, II”, Tiranë, 1974, f. 119.

⁹ R. Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, f. 247.

¹⁰ B. Bokshi, *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984, f. 20.

Nyja e prapme e shqipes dhe prejardhja e saj

gjuhët ballkanike. Në lidhje me gjuhën shqipe ai ishte shprehur se prapavendosja e nyjës është e lashtë që nga dakishtja apo dakomezishtja. Në një rast tjetër, Georgiev, në librin e tij, *Le dace comme substrat de la langue roumaine*, RRI, 1-2, 1965, f. 75, thoshte, Bokshi, ishte shprehur se “për të shpjeguar nyjën e gjuhës shqipe, duhet shikuar si trashëgim i indoevropianishtes..., sepse disa përemra dëftorë janë përdorur edhe në vend të nyjës...”.¹¹

Ndërkaq, sipas studiuesit Besim Bokshi, “Në parim, nyja shquese e prapavendosur del në shqipen për shkak të ndryshimit të rendit të përcaktorëve, pas debalansimit të sistemit të mbaresave rasore në tërësi në këtë gjuhë, që do të thotë se më parë ky rend ishte i ndryshëm: *i ati, im atë, ime ëmë*; me ndryshimin e rendit të përcaktorëve u krijua mundësia që edhe mbiemri të dalë prapa me renditje të zakonshme, po edhe nyja me origjinë prej dëftorit të dalë para mbiemrit, pra edhe prapa emrit.”¹²

Marko la Piano, shprehej prof. Besim Bokshi, që më 1939, thoshte se: “Është absurd të kërkohen për këtë proces morfologjik, karakteristik për shqipen, ndikime të mundshme nga latinishtja qoftë ballkanike, dhe akoma më keq, ndikimet e elementeve më të vonshme si: bullgarishtja e rumanishtja” ai u shpreh më pas se: Vetëm shqipja mund të jetë ajo gjuhë që ndikoi mbi rumanishten e mbi bullgarishten, sepse nyja në këto gjuhë është shfaqur shumë vonë (në rum. Në shek. X, në bullgarishte, në shek. XVII).¹³

Prof. Gjinarit shprehej se greqishtja e vjetër s’mund të jetë burim i mundshëm nga i cili është përfutur nyja e prapme e shqipes sepse ka nyje të përparme dhe strukturë të ndryshme nga ajo e shqipes dhe rumanishtes. Ndërkaq, shprehej ai, maqedonishtja e vjetër, nuk mund të konsiderohet, si burim, në këtë rast për arsye historike, gjeografike, për faktin se ka rreth katër hipoteza, mendonte ai, se gjuha maqedonase ishte:

- Dialekt i greqishtes;
- Gjuhë me origjinë ilire;
- Gjuhë me origjinë trake;
- Gjuhë e afërt me greqishten.¹⁴

Si burim i nyjës së shqipes mbeten të shikohen dy gjuhë të vjetra të Ballkanit, si ilirishtja dhe trakishtja (dakomyzishtja).

Sipas Jorgji Gjinarit: Trakishtja (dakomizishtja) nuk është ajo gjuhë e vjetër e Ballkanit ku duhet të kërkojmë burimin e nyjës së prapme të shqipes. Ai solli shembujt nga Vl. Georgiev, për trakishten e që ka karakteristikë: toponimet ditematike p.sh. **Drizupara (Drizu+para)**; **Scelabria (scela+bria)**. Siç shihet kompozitat e trakishtes kanë strukturë të tillë, ku përcaktuesi vendoset përpara elementit që përcaktohet: **i mirë ujë**, ndërsa shqipja ka: **ujë i mirë**. Kjo strukturë u

¹¹ Po aty, f. 39.

¹² R. Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, f. 70.

¹³ Po aty, f. 21.

¹⁴ J. Gjinarit, *Mbi nyjen e prapme të shqipes në aspektin e lidhjeve gjuhësore iliro-shqiptare*, në: “Studime ilire, II”, Tiranë, 1974, f. 124.

tha se e largon shqipen nga trakishtja (shqipja në këtë pikë afrohet me rumanishten), sepse shqipja ka strukturë me rend të kundërt, qoftë në kompozita si: **Gurakuqi, Togfjalësja si: Mali i Zi, Guri i Bardhë**, etj.¹⁵

Prof. Çabej te emri **Scupi**, i kohës antike, sheh mundësinë e identifikimit të –i-së fundore, të këtijë toponimi, me nyjën e prapme –i, të shqipes.¹⁶

Pra, në përfundim të këtij punimi mund të themi se, në bazë të studimeve onomastike, mund te shihet se emrat ilir të qyteteve, rregullisht dalin monotematik, si p.sh.: emrat **Ulcinium, Drinus etj.**, apo emra njerëzish si: **Plator, Bato** etj. Pra nga këta shembuj e shumë të tjerë, mund të shihet se ata kanë strukturë krejtësisht ndryshe nga trakishtja dhe myzishtja, ku emra të këtillë na dalin si kompozita: **Drizupara, Mesembria**, etj.¹⁷, prandaj, mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në këto të dhëna, Jorgji Gjinari shprehej se, burimin e nyjës së prapme të shqipes, duhet kërkuar tek ilirishtja.

Bibliografi

- E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, në: “Studime Gjuhësore, IV”, Prishtinë, 1977, f. 103-130.
- B. Bokshi, *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984.
- J. Gjinari, *Mbi nyjen e prapme të shqipes në aspektin e lidhjeve gjuhësore iliro-shqiptare*, në: “Studime ilire, II”, Tiranë, 1974, f. 119-127.
- R. Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, f. 247.
- B. Beci, *Tiparet e përbashkëta gjuhësore ballkanike në dritën e të dhënave të gjuhës shqipe*, në: Seminari XVIII Ndërkombëtar Për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1996, f. 455-464.

¹⁵ Po aty, f. 125.

¹⁶ Po aty, f. 124.

¹⁷ Po aty, f. 126.